

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Zero Tek Një” SHPK

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri, Themeluesit, Objekti

1.1 Sot me date 09.09.2019, bazuar ne Aktin e Themelimit krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “Zero Tek Një” SH.P.K .

1.2 Themeluesit e shoqerise “Zero Tek Një” SH.P.K jane ortaket e meposhtem:

Z. Donjaldo Hoxha, shtetas shqiptar, i biri i Yllit, lindur me 30.04.1991 ne Permet, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, banues ne Tirane, me numer personal Nr. J11230024H.

Z. Xhulio Mitre shtetas shqiptar, i biri i Dhimitrit, lindur me 19.04.1992 ne Permet, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, banues ne Tirane, me numer personal Nr. J20419115K

Neni 2

Objekti

2.1 Shoqeria “Zero Tek Një” SH.P.K do te zhvilloje aktivitetin me objekt:

Analize, Planifikim, Implementim, Testim, Dokumentim, Instalim, Zhvillim dhe Mirembajtje e Sistemeve te Menaxhimit te Informacionit dhe sistemeve te ndryshme software-ike. Menaxhim dhe drejtim projektesh ne fushen e teknologjise se informacionit, zhvillimit te bizneseve, realizimit te investimeve, kontrollit dhe implementimit te sistemeve arsimore, trajnimeve ne e-learning dhe digital marketing, mentorimit te startup-eve, implementimit te sistemeve te sigurise se informacionit, zhvillimit rural, turizmit rural, bujqesise, agroperpunimit, agroturizmit, etj.

Dizenjim software-i. Analiza e keerkesave te sistemit software, projektimi i arkitekturees dhe projektimi i detajuar i sistemit software; Zhvillim dhe mirembajtje sistemesh software. Programimi i sistemeve software, instalimi, integrimi i te gjithë komponenteve, dokumentimi,

1 | AKT THEMELIMI DHE STATUTI



identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, (modifikimet pas momentit që software-i është vendosur ne operim), mirembajtja e te gjithë komponenteve, suporti i sistemit si nje teresi komponentesh, qe, ne funksionimin e tyre, realizojne qellimin e zgjidhjes informatike; Aktiviteti i Manaxhimit te Projekteve qe lidhen me aktivitetet e Zero Tek Nje Shpk.

Aktiviteti i konsulences ne fushen e software aplikative. Dizenjim dhe zhvillim sistemesh te sigurise. Analiza e kerkesave te sigurise se klientit, projektimi i arkitektures, instalimet dhe konfigurimet e komponenteve, vendosja ne pune, testimet e sigurise dhe mirembajtja perkatese; Permiresim/upgrade sistemesh informatike; Operimi, menaxhimi, suporti i perdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik per sistemet software.


Import dhe rishitje ne Shqiperi dhe jashte Shqiperie, ne menyre direkte dhe indirekte e produkteve informatike (software dhe hardware). Import, Export, shitje, rishitje dhe tregetim i cdo lloj programi kompjuterik dhe mirembajtja e tyre. Aktiviteti i shitjes se licencave software dhe sherbimeve perkatese te lidhura me to. Kryerja e veprimtarive te tjera tregtare si shitja dhe blerja me shumice dhe pakice te artikujve te kancelarise. Import, shitje dhe tregetim printerash, skanerash, fotokopjesh te llojeve te ndryshme se bashku me aksesoret e tyre. Sherbim mirembajtje printerash, fotokopjesh, skanerash te te gjitha llojeve (te thjeshte, multifunksional etj).

Hartim, krijim dhe implementim rrjeti kompjuterik dhe sherbim mirembajtje rrjeti kompjuterik, duke perfshire dhe mirembajtjen e te gjitha pajisjeve kompjuterike qe jane pjese perberese e nje rrjeti kompjuterik si printera, skanera, fotokopje, kompjutera desktop, kompjutera laptope, server, router, switch, sisteme alarmi, sistemi akses kontrolli, sisteme sigurie, sisteme kamerash etj. Ofrim i sherbimit te krijimit te dhomave te serverave me te gjithë elementet e nevojshem sipas standarteve te kerkuara nga klienti.

Aplikim dhe implementim te projekte te ndryshme te cdo lloj fushe (Teknologji Informacioni, IT, Software, Hardware, Bujqesi, Turizem, Agroperpunim, Zhvillim Rural, Turizem Rural, Agroturizem, Siguri Informacioni, Zhvillim Biznesi, Energji, Siguri, etj), duke perfshire OJF, administraten publike, donatore vendas dhe donatore te huaj, organizata dhe institucione nderkombetare dhe perfaqesite e tyre ne Shqiperi, kompani private shqiptare dhe kompani private te huaja, banka te nivelit te dyte dhe banka qendrore, fonde dhe institucione mikro dhe makro financimi shqiptare dhe te huaja, etj.

Hartim dhe pergatitje te plote te planeve te biznesit ne te gjitha fushat me te gjithë elementet perberes, duke perfshire pjeset pershkruese dhe financiare per aplikime ne institucione kombetare(shteterore dhe private), institucione nderkombetare, banka te nivelit te dyte, fonde dhe institucione mikro dhe makro financimi, BERZH, Banka Boterore etj dhe te tjera organe te natyrave te ngjashme. Hartim dhe pergatitje e te gjitha dokumentacionit te nevojshem per aplikim per mbeshtetje financiare ne grante me donatore qeverine shqiptare dhe grante me donatore te huaj ne te gjitha fushat (Teknologji Informacioni, IT, Software, Hardware, Bujqesi,

2 | AKT THEMELIMI DHE STATUTI



Turizem, Agroperpunim, Zhvillim Rural, Turizem Rural, Agroturizem, Siguri Informacioni, Zhvillim Biznesi, Enejji, Siguri, etj.) per bizneset, shoqerite, fermeret, individet, entet publike dhe private, studio profesionale etj.

Sherbime informacioni. Rekuperime dhe ristrukturime kredish. Trajnime, konsulenca profesionale, juridike, hartime kontratash, perkthime, marketing, etj. Realizim studimi tregu sipas nevojave te paleve te treta, hartim specifikimesh teknike ne perputhje me kerkesat e paleve te treta. Konsulence te plote financiare dhe juridike, perfaqesim ne te gjitha institucionet e administrates publike, institucionet gjyqesore, perfaqesimin per marredhenie te ndryshme me palet e treta.

Studim, analizim dhe hartim planesh zhvillimi te zonave rurale dhe zonave me interes te vecante ekonomik ku perfshihen edhe zonat e investimeve strategjike. Konsulence ne sektorin e te dhenave(big data); Pjesemarrje dhe hartim ne akt ekspertiza te te gjitha fushave te Teknologji Informacioni, IT, Software, Hardware, Bujqesi, Turizem, Agroperpunim, Zhvillim Rural, Turizem Rural, Agroturizem, Siguri Informacioni, Zhvillim Biznesi, Enejji, Siguri, etj.

Krijimi, menaxhimi e realizimi i fushatave marketing. Menaxhimi e perditeseimi i llogarive te rrjeteve sociale, ngarkimi e shkarkimi i materialeve. Dergimi i e- maileve promocional e te lidhura me te. Menaxhim e perditeseim i llogarive te rrjeteve sociale. Realizimi dhe prodhimi i spektakleve dhe shfaqjeve argetuese, pergatitje, sherbim menaxhim dhe mbeshtetje teknike per konferenca, kongrese dhe ceremoni.

Prodhimi dhe shperndarja e programeve publicitare. Shitja e hapesires publicitare televizive, radiofonike, interneti; sinjalistika rrugore. Krijimi i fushatave publicitare. Realizimi i projekteve per marketing dhe komunikim publicitar si dhe zbatimi i tyre ne emer te organeve publike, shoqerite private dhe me vete, per prezantimin dhe promovimin e shitjes, ne tregjet europiane dhe jashte Europes, te produkteve dhe sherbimeve; Aktivitetet e sherbimeve te konsulences menaxheriale te lidhura me to, sherbime te kerkimit te tregut dhe sondazh te opinionit publik, sherbime publicitare, sherbimet botuese dhe Shtypi si sherbime informatike dhe te lidhura me to.

2.2 Per te arritur objektin te saj, Shoqeria, me vendim te Asamblese mund te realizoje drejtperdrejte apo ne menyre te terthorte çdo lloj pjesemarrje ne shoqeri te tjera shqiptare apo te huaja.

2.3 Shoqeria, dhe me qellim arritjen e objektit te saj, mund te lidhe marreveshje tregtare apo bashkepunimi me shoqeri apo ndermarrje te tjera, si dhe te kryeje çdo veprim tregtar qe do ta konsideroje te nevojshem.

Neni 3

Kohezgjatja

3 | AKT THEMELIMI DHE STATUTI



3.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin qe ka per objekt ne nje periudhe kohore te pacaktuar.

Neni 4

Selia

4.1 Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Zero Tek Një" SH.P.K do te zhvilloje aktivitetin e saj ne adresen: Rruga "Nikolla Lena", Nr.57/1, Tirane.Prona me Nr.Pasurie 4/74 ND dhe ZK.8250

4.2 Shoqeria mund te kete edhe adresa te tjera te ushtrimit te veprimtarise, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale dhe/ose te realizoje cdo lloj pjesemarrje ne shoqeri te tjera, sic parashikohet nga ligji si brenda ashtu edhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise, sipas nje vendimi te organit administrativ.

Kreu II

Kapitali, Kuotat, Te drejta te lidhura me to

Neni 5

Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte ne vleren 100 (njqind) Leke.

Neni 6

Kuotat, Te drejta te lidhura me to

6.1 Secili nga ortakët zoteron :

1. Z. Donjaldo Hoxha, zoterues i 1 (nje) kuote qe perben 50.00% te kapitalit themeltar te shoqerise
2. Z.Xhulio Mitre, zoterues i 1 (nje) kuote qe perben 50.00% te kapitalit themeltar te shoqerise

6.2 Cdo kuote jep te drejten e nje vote per te marre vendime sipas Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"

Neni 7

Kuotat, Fitimi, Transferimi i kuotave

4 | AKT THEMELIMI DHE STATUTI



- 7.1 Kuotat e kapitalit te shoqerise mund te fitohen nepermjet kontributit ne kapitalin e shoqerise, shitblerjes, trashegimise, dhurimit si edhe cdo menyre tjeter te parashikuar nga ligji.
- 7.2 Ortaket kane te drejte te shesin kuotat e tyre tek te tretet por kjo pasi te jete ofruar e drejta e blerjes ortakeve brenda shoqerise. Oferta u drejtohet me shkrim ortakeve, qe kane te drejten e parablerjes, e cila ushtrohet me shkrim brenda 30 diteve nga data e komunikimit, ne te kundert oferta konsiderohet e refuzuar prej ortakeve qe gezojne kete te drejte.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

- 8.1 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise i perbere nga gjithë ortaket e saj.
- 8.2 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas parashikimeve ligjore.
- 8.3 Ortaku mund te perfaqesohet me ane te nje autorizimi nga nje ortak tjeter ose nje person i trete.
- 8.4 Ne mbledhjet e Asamblese administratori nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve te shoqerise.
- 8.5 Asambleja thirret me shkrese jo me vone se 7 dite perpara dates se mbledhjes, ne seline e shoqerise ose ne nje vend te njohur nga ortaket.

Neni 9

Kompetencat e Asamblese

- 9.1 Asambleja e ortakeve ushtron kompetencat si meposhte:
- Ndryshimet ne statutin e shoqerise
 - Emerimet dhe shkarkimet e administratoreve te shoqerise
 - Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise

5 | AKT THEMELIMI DHE STATUTI



- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- Pjesetimin e kuotave edhe / ose anulimin e tyre
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- Ceshtje te tjera te percaktuara nga ligji ose statute.

Neni 10

Perfaqesimi ne Asamble

- 10.1 Ortaku mund te perfaqesohet me ane te nje autorizimi nga nje ortak tjetër ose nje person i trete.
- 10.2 Ne mbledhjet e Asamblese administratori nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve te shoqerise.

KREU IV

Neni 11

Administratori

- 11.1 Administrator i pare i shoqerise do te jete ortaku:

Z. Donjaldo Hoxha, shtetas shqiptar, i biri i Yllit, lindur me 30.04.1991 ne Permet, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, banues ne Tirane, mbajtes i leternjofimit Nr. J11230024H.

- 11.2 Administratori emerohet per nje afat 5 vjecar me te drejte ripertesitje.

Neni 12

Te drejtat dhe detyrimet e Administratorit, Pergjegjesite

- 12.1 Administratori kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise duke zbatuar te gjitha politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme.
- 12.2 Drejton dhe organizon punen ne menyre te tille qe te siguroje suksesin e shoqerise ne veprimtarine e saj ekonomiko-financiare.
- 12.3 Kryen emerimin dhe shkarkimin nga puna te punemarresve te shoqerise
- 12.4 Jep urdhra dhe udhezime punemarresve

6 | AKT THEMELIMI DHE STATUTI



- 12.5 Vepron me te tretet ne emer dhe perlllogari te shoqerise brenda kompetencave te parashikuara ne kete statut dhe/ose ligjin "Per tregtare dhe shoqerite tregtare".
- 12.6 Te ushtroje te drejta dhe detyrime te tjera te percaktuara nga Ligji Nr. 9901 "Per tregtare dhe shoqerite tregtare".

Neni 13

Mbarimi i mandatit te administratorit

- 13.1 Mandati i administratorit perfundon:
- Me doreheqjen vullnetarisht te vete administratorit
 - Me shkarkimin e tij nga Asambleja Ortakeve
 - Me mbarimin e afatit te parashikuar
 - Me cdo menyre tjeter te parashikuar nga Ligji "Per tregtare dhe shoqerite tregtare"

KREU V

Viti Financiar, Prishja e shoqerise, Riorganizimi i shoqerise, Dispozita te Fundit

Neni 14

- 14.1 Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar i shoqerise fillon ne daten e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet ne 31 Dhjetor.

Neni 15

Prishja e Shoqerise

- 15.1 Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:
- Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
 - Me vendim te asamblese se ortakeve
 - Me hapjen e procedurave te falimentimit
 - Sipas rasteve te parashikuara nga Ligji "Per tregtare dhe shoqerite tregtare"

Neni 16

Riorganizimi i Shoqerise

- 16.1 Shoqeria mund te ndahet ose te bashkohet sipas vendimit ne mledhjen e pergjithshme te Asamblese se ortakeve ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Ligjin "Per tregtare dhe shoqerite tregtare".

7 | AKT THEMELIMI DHE STATUTI



Neni 17

Baza Ligjore

- 17.1 Shoqeria do te kryeje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 17.2 Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut do te zbatohen dispozitat e Ligjit "Per tregtare dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil si edhe cfaredo ligji tjetër specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 18

Mosmarreveshjet

- 18.1 Per cdo mosmarreveshje qe mund te lindi per interpretimin e ketij statuti, si edhe mosmarreveshjet qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteve secila pale mund ti drejtohet Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

ORTAKET

E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"Zero Tek Një" SH.P.K

Donjaldo Hoxha

Donjaldo Hoxha
Hoxha
2018

Xhulio Mitre

Xhulio Mitre
Xhulio